



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 14 Prot

Tiranë, më 06.01.2026

VENDIM

Nr. 1, datë 06.01.2026

Për hapjen e platformës online të “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”

Bazuar në Statutin e Akademisë së Shkencave, i ndryshuar, VKA nr. 3, datë 10.01.2024 “Për ngritjen e Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike” dhe në VKA nr. 54, datë 16.09.2021 “Për caktimin e drejtuesve të nëngrupeve sipas fushave të projektit “Fjalor i madh i gjuhës shqipe” dhe mënyrës së shpërblimit të drejtuesve, anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve”, në përmbyllje të punës për hartimin e maketit të Fjalorit të madh të gjuhës shqipe, dorëzuar pranë QBEA-së më datë 24 dhjetor, pas konfirmimit se e gjithë lënda e veprës është në platformën online: fjalori.online,

VENDOSI:

1. Të hapë për publikun faqen e platformës online të “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”, me domenin “fjalori.online”, duke ofruar qasje të lirë në të.
2. Nga dita e hapjes, për një periudhë nëntëmuajore mbledhen mendime, sugjerime e plotësime për përmirësimin e Fjalorit.
3. Pas kësaj periudhe, redaksia e Fjalorit dhe koordinatori teknik, brenda një afati tremujor, pasqyrojnë gjithë sugjerimet e mbledhura.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike dhe redaksia e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Akad. Skënder GJINUSHI